



Michael Ende

Shkolla e Magjisë *dhe histori të tjera*



Ilustrimet nga Regina Kehn

Përktheu: *Doreida GEDAJ (KAFEXHIU)*



Botimet DUDAJ




Titulli i originalit: *Die Zauberschule und andere Geschichten*
by Michael Ende (author) & Regina Kehn (illustrator)

Ende, Die Zauberschule und andere Geschichten © 2008 by Thienemann Verlag
(Thienemann Verlag GmbH), Stuttgart/Wien

Copyright © of the translation: S. Fischer Fondation by order of Traduki
Copyright © i përkthimit: S. Fischer Fondation, me kërkesë të Traduki
traduki™

Ky libër u botua me ndihmën e TRADUKI - një fondacion për letërsinë, që u nis bashkërisht nga Ministria Federale e Austrisë për Çështjet Europiane dhe Ndërkombëtare, Ministria Federale e Punëve të Jashtme e Gjermanisë, Swiss Arts Council Pro Helvetia, Kulturkontakt Austria, Instituti Goethe, Fondacioni S. Fischer.

Redaktore: Arlinda Hovi Dudaj
Kopertina: Studio grafike 
Designer: Vlash Papa
Përpunimi grafik: Greta Konomi



ISBN 978-99943-0-189-8
Shtypur në Shtypshkronjën "Guttenberg"
Tiranë, 2010

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 41 pranë Universitetit
"Marin Barleti", godina nr. 4, Tiranë.
Tel. - fax.: 00355 4 249 944
E-mail: info@botimedudaj.com
Website: www.botimedudaj.com

Përmbajtja

Në vend të parathënies	
<i>Ta marrësh hollë-hollë</i>	7
Shkolla e Magjisë.....	15
Qetë-qetë Çapçapitura, breshka këmbëngulëse	45
Palaço-dordoleci i vogël	55
Sekreti i Lenkës	62
Historia e dëshirës së të gjitha dëshirave.....	93
Norbert Qafëtrashi ose hundëbriri lakuriq.....	99
S'prish punë.....	117
Hundëpërpjeti dhe Hundëlezeti	128
Histori gjuhëzhdërvjelltësh	144
Param Paré, Plusko-Përse	
<i>Një histori pa kuptim, për të qeshur,</i> <i>për të gjithë përse-pyetësit e vegjël</i>	148
Moni pikturon një kryevepër.....	155
Historia e supierës dhe luhares.....	161
Arush Tedi dhe kafshët e tjera.....	184
Udhë e gjatë për në Santa Kruz.....	197
Dragoi dhe flutura ose këmbimi i çuditshëm.....	240
Filemon Rrudhashumi	246
Një natë e keqe	260
Kollofitësi i ëndrrave	267
Teatri i hijeve të Ofelisë	276





Në vend të parathënies

Ta marrësh hollë-hollë

Të gjithë pjesëtarët e familjes sonë, që nga më i moshuari e deri te më i riu, kanë të njëjtën dobësi: leximin. Vësh-tirë ta bësh ndonjërin prej nesh që, për ndonjë arsye, ta lërë një çast librin mënjanë dhe të merret me diçka tjetër të ngutshme apo që nuk pret. Kjo nuk do të thotë se ajo çka është e ngutshme apo që nuk mund të shtyhet për më vonë, nuk bëhet fare. Jo, vetëm se, për ne, natyrisht, nuk është e nevojshme që, për këtë arsye, ta ndërpresim lexi-min. Shumë bukur, mund të bësh një gjë pa e lënë tjetrën përgjysmë, apo jo? E pranoj që, ndërsa bën kështu, ndonjë-herë ndodh edhe ndonjë zarar i vogël - po ç'rëndësi ka?

Gjyshi rri ulur, po themi, në një kolltuk të rehatshëm nga ata me veshëmbështetëse, thith llullën dhe mban një libër në dorë. Po lexon. Pas pak çastesh, zbraz llullën në tavllën e duhanit, që ndodhet përpara tij. Ndërkaq, ta ma-rrësh hollë-hollë, nuk është tavlla e duhanit, por një vazo lulesh. Tingulli i trokitjes e kujton gjyshin vagëllimthi se duhej të kishte pirë ilaçin kundër kollës. Dhe kështu, rrë-mben vazon e lules dhe e pi gjithë ujin që ndodhet në të.

- Hëmmm, hëmmm, - gërnjit ai. - Kafeja sot qenka shqeto fare... dhe, medet, sa e ftohtë!

Gjyshja rri ulur, po themi, në divanin që ndodhet në qoshen tjetër të dhomës. Ka vënë gjyzlykët mbi hundë dhe kërcet shtizat. Në prehër mban një libër të trashë, që është duke e lexuar. E ndërkohë që punon me shtiza, punon e punon - ç'është duke bërë ashtu? Me siguri ndonjë çorape. Tani, ta marrësh hollë-hollë, nuk duket dhe aq si çorape, por më shumë si një lloj gjarpri gjigant prej leshi, që spërdridhet sa gjatë-gjerë në dyshemenë e dhomës. E ndërsa kthen faqen, gjyshja hedh shikimin përmbi syze, drejt kafshës së stërmadhe, pastaj mërmërit:

- E po, më duket se do ketë rënë prapë zjarr këtej rrotull. E megjithatë, zjarrfikëset nuk duhej ta kishin lënë te ne zorrën e ujit, ashtu si pa të keq.

Babai pikturon portrete. Ai ndodhet, po themi, në atelienë e tij, përpara kanavacës, ku po vizaton portretin e një zonje të fisme, e cila rri ulur para tij mbi një si punë podiumi dhe mban në kokë një kapele të vogël të këndshme me lule, ndërsa në prehër ka një këlysh qeni nga ata trupshkurtrit. Babai përdor vetëm njëren dorë për të pikturuar, sepse në tjetrën mban librin që po lexon. Kur, më në fund, portreti është gati, zonja e pasur dhe e fisme ngrihet, afrohet qetë-qetë dhe admiron imazhin e saj. Oh, ka dalë një pikturë shumë e bukur! Tani, ta marrësh hollë-hollë, është ca e çuditshme, se babai e ka pikturuar zonjën me turirin e qenit, ndërsa këtij të fundit, ashtu ndenjtur në prehër, i ka vizatuar fytyrën e zonjës. Ndaj dhe zonja largohet tepër e indinjuar dhe nuk e blen portretin e bukur.

- E po, ndoshta nuk është aq sa për të fluturuar nga gëzimi, - thotë i trishtuar babai, - por i ngjan shumë, ama.

Mamaja është, po themi, në kuzhinë dhe po gatuan drekën. Për fat të mirë, ka harruar ta ndezë gazin poshtë tenxheres, se përndryshe gjella tanimë do kishte marrë në të zezë. Në dorë mban një libër dhe po e lexon. Në dorën tjetër ka luharen e madhe, me të cilin trazon e trazon. Tani, ta marrësh hollë-hollë, nuk është luharja e madhe ajo që mban në dorë, por një termometër. Nuk kalon shumë dhe e vë pranë veshit e, duke tundur kokën, thotë:

- Paska mbetur sërish një orë mbrapa. E po, kështu s'kam për t'u bërë ndonjëherë gati në kohën e duhur.

Motra e madhe (ajo është katërmëdhjetë vjeçe) është ulur, po themi, në korridor, pranë telefonit dhe, gjithë kërshëri, ngjesh receptorin pas veshit. Dihet nga të gjithë që telefonat sikur janë shpikur enkas për motrat katërmëdhjetëvjeçare, se pa receptor në vesh, të gjitha motrat katërmëdhjetëvjeçare të botës me siguri që do të kishin vdekur nga mungesa e lajmeve, ashtu si zhytësit për mungesë ajri, ngaqë nuk kanë bombolat e oksigjenit. Por kjo motra jonë katërmëdhjetëvjeçare, përveç receptorit, mban në dorë edhe një libër, që është duke e lexuar. E megjithatë, ajo i dëgjon mjaft mirë historitë interesante që po ia tregon shoqja e saj. Tani, ta marrësh hollë-hollë, nuk është se dëgjon dhe aq mirë, se ende nuk i ka rënë telefonit. Dhe dikur, pas rreth nja dy orësh, pyet, më në fund, si nëpër tym:

- Pa dale, dale, më thuaj njëherë, kush është ky Bipi, për të cilin po më flet gjithë kohën?

Vëllai i vogël (ai është dhjetë vjeç) është duke shkuar, le të themi, në shkollë. Natyrisht që edhe ai mban një libër në dorë dhe po lexon - se ç'gjë tjetër më të mirë mund të bëjë gjatë rrugës së gjatë në tramvaj? Tramvaji tundet e shkundet dhe shkon lart e poshtë, por nuk lëviz shumë nga vendi dhe, ta marrësh hollë-hollë, djali nuk është në



një tramvaj të vërtetë, por në ashensorin e shtëpisë sonë, nga i cili vëllai ka harruar fare të dalë. Pasi kanë kaluar disa orë dhe ai sheh se ende nuk ka mbërritur në stacionin e shkollës, atëherë mërmërit i shqetësuar:

- Me siguri, mësuesi s'ka për të më besuar as kësaj radhe që nuk është faji im pse shkoj kaq vonë në shkollë.

Anëtari më i ri i familjes sonë, Bebushi, rri shtrirë në koshin e vet. E, natyrisht, në familjen tonë lexon edhe Bebushi. Si gjithë të tjerët, edhe ai mban një libër në dorë, ca më i vogël e më i lehtë se librat e të tjerëve, pra një libër bebesh. Në anën tjetër mban biberonin, pasi detyra e tij, që ai e merr shumë seriozisht, është të ushqehet mirë, të bëhet i madh e i fuqishëm, me qëllim që së shpejti të arrijë të lexojë libra më të mëdhenj e më të rëndë. Megjithëse, ta marrësh hollë-hollë, në të vërtetë, ajo që mban në dorë nuk është biberon, por një kallamar i madhe boje. Dhe nuk po e pi, por thjesht, herë pas here, e tund mbi kokën e vockël, çka nuk e shqetëson aspak, deri në çastin kur një goxha njollë i bie mbi faqen e librit që është duke e lexuar dhe nis të bërtasë e të thërrasë me sa ka në kokë (dhe unë shpresoj


që askush të mos ketë dyshime që Bebushi ynë leximtar di që tani, sigurisht, edhe të flasë më së miri):

- Po le të shkojë ndonjëri e të hapë dritën. S'e shikoni sa u errësua?

Macja jonë, si të gjitha macet e tjera, ka për detyrë të kapë minj. Profesionit për të është mbi gjithçka, ndaj dhe, për orë të tëra, rri ulur, po themi, përpara një vrime minjsh në fund të dhomës, në anën e majtë, pranë dollapit të rrobave. E, natyrisht, edhe ajo mban në putra një libër - se ç'gjë tjetër më të mirë mund të bëjë gjatë gjithë asaj kohe të gjatë përgjimi, se sa të lexojë? (Dhe kush e beson se një mace mund të lexojë, nuk duhet të habitet që edhe mund të flasë). Pra, sikurse thamë, ajo po rri ulur përpara vrimës së minjve. Tani, ta marrësh hollë-hollë, nuk është tamam një vrimë minjsh. Ndërsa ishte duke lexuar, minjtë e kishin kthyer në anën tjetër dhe e kishin shtyrë më tutje dhe ja tek është përpara një prize në mur. Pas pak kërcen me gjithë kthetra brenda saj dhe priza nis të lëshojë xixa deri në fund të bishtit.

- Mjauuu, - mjaulliti e tmerruar, - në çfarë tensioni të mbajtka ky libër!

Bretku ynë po rri, le të themi, në kavanozin e vet. Ai ka një detyrë të rëndësishme: duhet të parashikojë motin duke hipur apo duke zbritur në shkallëzën e vet. Në të vërtetë, ai e përmbush këtë detyrë në mënyrë shumë të vetëdijshme, për sa kohë që nuk është duke lexuar, ngaqë, sikurse mund ta merrni me mend edhe vetë tanimë, te ne edhe bretku ka një libërth të bërë enkas për bretkosa: në madhësinë e një pulle poste dhe rezistent ndaj ujit. (Nuk po humbim kohë të shpjegojmë se, një bretk që lexon, edhe flet më së miri). Tani çështja qëndron këtu: që bretku është pothuaj gjithë kohën duke lexuar, ndaj dhe nuk i kushton vëmendjen e duhur profesionit të vet kryesor. Por ndonjëherë e pushton papri-



tur një brerje ndërgjegjeje dhe i bien ndërmend detyrimet e veta. E në këtë çast, për të dëshmuar dëshirën e mirë, lëshohet befasi me vrap dhe ngjitet gjithë nxitim shkallëzën, gjithë pa e lëshuar librin nga dora e lagur. Ose zbret nga shkallëza me po të njëjtin nxitim dhe pa asnjë shkak. E, në fakt, ta marrësh hollë-hollë, nuk është se i zbret shkallët njëra pas tjetrës, por këmba i zë në boshllëk dhe atëherë rrokulliset gjithë rrapëllimë tatëpjetë.

- Nëse e kuptoj siç duhet veten, - thotë me kuak-kuak, pastaj duke fërkuar këmbën e gjelbër, - së shpejti do të kemi stuhi.

I vetmi që nuk lexon në familjen tonë është - pa shiko! - krimbi i librave, i cili banon në vëllimin e tetë të enciklopedisë madhështore të Brockhaus-it. Jo, ai nuk lexon. Librat ai i provon vetëm për të parë sa të ngrënshme janë. Andaj edhe gjykimi i tij për librat me "shije të mirë" apo me "shije të keqe" ka, të paktën në këtë pikëpamje, një vlerë shumë të kufizuar dhe të gjithë ne të tjerët nuk e quajmë atë si një pjesëtar të vërtetë të familjes.

Mbase tani je duke pyetur se ç'lidhje farefisnore kam unë me anëtarët e tjerë të familjes. Më duhet ta them hapur se edhe vetë nuk jam shumë i qartë në lidhje me këtë. Tani, ta marrësh hollë-hollë, unë nuk i njoh fare këta njerëz ose, thënë mes nesh, as nuk besoj që këta mund të ekzistojnë me të vërtetë. Ka shumë mundësi që e gjithë kjo histori, që sapo e tregova këtu, mori këtë formë që mori, sepse, ndërsa po shkruaj, njëkohësisht jam edhe duke lexuar një libër, që e kam përpara.



Dhe unë nuk mund t'ju këshilloj gjë tjetër, veçse të bëni po të njëjtën gjë. Tani, ta marrësh hollë-hollë, këtë jeni duke bërë se, përndryshe, nuk do të kishit lexuar deri këtu. Atëherë, mbani qetësi dhe më lini edhe mua të lexoj!

Shkolla e Magjisë



Ngaqë jam i sigurt se lexuesit e mi të rinj tani po digjen nga kureshtja për gjithçka që lidhet me këtë shkollë (apo nuk është kështu?), dua t'ju rrëfej njëherë se si zhvillohet mësimi në Mbretërinë e Dëshirave.

Mbretëria e Dëshirave është ai vend për të cilin, në përralla dhe në histori të ndryshme, thuhet se “dëshirat ende të ndihmojnë”. Dhe, në të vërtetë, nuk ndodhet shumë larg botës sonë të përditshme, siç mund të mendojnë shumica e njerëzve, por megjithatë është shumë e vështirë të shkosh atje. Kjo është e mundur vetëm po të kesh marrë një ftesë personale, pasi banorët e Mbretërisë së Dëshirave nuk e duan fare

turizmin masiv. Për këtë mund t'i vijë keq ndonjërit, por, të themi atë që është: më mirë që ndodh kështu - ashtu siç do ta shohë çdonjëri prej jush që lexoi këto fjalë.

Nga ky vend vijnë pjesa më e madhe e magjistarëve të kohëve të shkuara. Në ditët e sotme, me shumë pak përjash-time, ata rrinë në shtëpitë e tyre. Madje mund të shihet që në Mbretërinë e Dëshirave të gjithë mund të bëjnë nga pak magji. Por, për ta mësuar siç duhet dhe plotësisht, duhet shkuar në një shkollë.

Përpara shumë e shumë vitesh - madje më parë se shumica prej jush të vinte në jetë - ndodhi që një nga udhëtimet e mia të mëdha të më shpinte në atë vend gojëdhënash (sikurse e thashë, pasi më kishin ftuar zyrtarisht, kuptohet). Për t'i studiuar me themel doket dhe zakonet e banorëve të atij vendi, ndenja atje për njëfarë kohe dhe pata rastin të njihesha ndërkaq me dy fëmijë, me të cilët zura miqësi. Ata ishin binjakë, një djalë me emrin Mug dhe një vajzë që quhej Amalavinta, shkurt Mali. Të dy ishin rreth nëntë vjeç, me sy të kaltër e flokë të zinj; ai të ngritur përpjetë si furçë, ndërsa ajo me bishtaleca. Këta ishin fëmijët e pronarëve të bujtinës ku unë kisha marrë një dhomë me qira, një familje tejet miqësore, që edhe fëmijët i kishte shumë të sjellshëm e që më ndihmonin sa mundnin në studimet e mia. E kështu ndodhte që, herë pas here, të shkoja në klasën e tyre gjatë mësimit. Zakonisht zija vend në bankën e fundit fare dhe dëgjoja pa bërë zhurmë, se nuk doja të shqetësoja të tjerët.

Meqë jemi këtu, jo gjithkush mund të pranohet të mësojë në një shkollë të tillë, por vetëm fëmijët që kanë dhunti të veçanta, çka nënkupton ata që kanë një forcë jashtëzakonisht të madhe dëshirash. Normalisht, të gjithë fëmijët janë në gjendje të kenë këtë apo atë dëshirë, por në shu-